

Escobari gjatë vizitës në Kosovë takoi familjen e heroit Afrim Bunjaku | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OSMANI THOTË SE ÇËSHTJA E DINARIT SERB NË KOSOVË DUHET TË ZGJIDHET URGJENTISHT.

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se çështja e dinarit serb në Kosovë duhet të zgjidhet urgjentisht. "Është urgjente që kjo çështje të zgjidhet", ka thënë Osmani në një konferencë për medie të

hënën, pas një vizite në qytetin e Lipjanit. Ajo nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me deklaratimet e zyrtarëve amerikanë të cilët kanë përsëritur ditët e fundit se kanë probleme në komunikim

me Qeverinë e Kosovës për shkak të mungesës së koordinimit. Megjithatë, ka thënë se çdo hap përpara që Kosova ka bërë, e ka bërë bashkë me aleatët euroatlantikë

BORRELLI PARALAJMËRON VAZHDIM TË PRESIONIT PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES KOSOVË - SERBI F. 5



MBI 46 MIJË QYTETARË ME TË DREJTË VOTE NË KATËR KOMUNAT VERIORE F. 3



ESCOBARI: MBËSHITESIM KONTRIBUTIN E MALIT TË ZI NË NATO DHE RRUGËN E SHITETIT DREJT BE-së F. 2

CRAMONI: QEVERISË SË KOSOVËS I MUNGON VULLNETI POLITIK PËR TË BËRË PËRPARIM NË RRUGËN E INTEGRIMEVE EVROPIANE F. 3

PREZIDENTJA OSMANI NIS VIZITAT NËPËR KOMUNA F. 6

EKONOMI



BOK-JA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E EDUKIMIT FINANCIAR ME PËRFAQËSUESIT E SEKTORIT FINANCIAR F. 8

KONTROLLET PËR IDENTIFIKIMIN E PUNËS SË PADEKLARUAR VAZHDOJNË NË GJAKOVË F. 8

SPORT



FODA: KOSOVA KA EKIP ME LOJTARË CILËSORË, DO TË ARRIJË REZULTATE TË MIRA F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Escobari: Mbështesim kontributin e Malit të Zi në NATO dhe rrugën e shtetit drejt BE-së

PODGORICË, 18 MARS - Shtetet e Bashkuara janë të kënaqura me lëvizjen e Malit të Zi drejt Bashkimit Evropian, tha i dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pas takimit me presidentin malazez Jakov Millatoviq dhe kryeministrin Millojko Spajiq. “ShBA-ja mbështet rrugën evropiane të Malit të Zi dhe kjo qeveri veçse ka ndërmarrë hapa të mëdhenj. Shumica e udhëheqësve në Mal të Zi kanë shfaqur vizion të madh”, tha Escobari gjatë konferencës për medie më 18 mars.

Duke komentuar rënien e mbështetjes për anëtarësimin e

Malit të Zi në NATO dhe për ndikimin rus, Escobari tha se Mali i Zi e ka mike të mirë ShBA-në, po ashtu është një aleat brenda aleancës. “Ndikimi malinj rus në rajon është shumë serioz. Pas pushtimit [rus] të Ukrainës, u bë e qartë se sa e rëndësishme është NATO-ja. Mali i Zi kontribuon si një partner i mirë, prandaj mund të pritet që të bëhet anëtar i ri i BE-së”, tha ai.

Raporti zyrtar vjetor i aleancës tregoi se 44 për qind e popullatës do të votonin që Mali i Zi të largohej nga NATO-ja, që është 20 për qind më shumë sesa dy vjet më parë.

Kryeministri i Malit të Zi, Millojko Spajiq, tha se rënia e mbështetjes

për aleancën është një gjë e së shkuarës. “Kemi parë shifrat e këtij raporti, por këto shifra i përkasin së shkuarës”.

Qeveria e Spajiqit është formuar katër muaj më parë.

Spajiqi tha se është i bindur që mbështetja e qytetarëve për NATO-n do të rritet sepse, sipas tij, qytetarët do të shohin vetëm përfitime nga anëtarësimi në aleancë, veçmas në fushën e ekonomisë. “Investitorët e shohin se nëse ju jeni anëtar të NATO-s, ju jeni më i besueshëm dhe siguria fizike është e rëndësishme. Kur jeni anëtar i NATO-s ju ofrohet siguri. Ky është përfitim nga anëtarësimi”.

Duke sqaruar deklaratën e tij

dhënë gjatë një interviste për Radion Evropa e Lirë, kur ai tha se “gjëja më e rëndësishme tani për Malin e Zi është që të mbështesë gjithçka që po bën kryeministri”, Escobari tha se ai u referua mbështetjes së asaj që Spajiq po bën për ta afruar shtetin e tij me BE-në. “Unë nuk mbështes individualisht kryeministrin në atë që ai bën në politikën e brendshme, por në atë që bën për ta bërë Malin e Zi anëtarin më të ri të tregut të përbashkët evropian”, tha Escobari.

Duke komentuar mundësinë që partitë e ish-koalicionit pro-rus të Frontit Demokratik të hyjnë në qeveri, Escobari tha se ShBA-ja kurrë nuk ka komentuar mbi

raportet në mes të kryeministrit dhe partnerëve të tjerë politikë. Por, ai shtoi se komuniteti ndërkombëtar e ka bërë të qartë se si partitë në Malin e Zi e pozicionojnë veten sipas vlerave të komunitetit euroatlantik. “Në këtë periudhë, tre anëtarë [autoritete në Mal të Zi] ndihmojnë në stabilitetin rajonal dhe një prej tyre nuk është aq konstruktive dhe bën deklaratat për Kosovën dhe shkakton turbulencë. Ka, po ashtu, një ndikim që shqetëson Bosnjë-Hercegovinën, që nuk ndihmon në përpjekjet e shtetit për BE dhe NATO. Komuniteti ndërkombëtar po vëzhgon retorikën e disa partive”, tha Escobari.



Putini fiton në zgjedhje pa një opozitë reale

MOSKË, 18 MARS - Presidenti rus Vladimir Putin përshëndeti fitoren për një mandat të ri gjashtëvjeçar, pas një procesi zgjedhor që nuk u dha votuesve ndonjë alternativë të vërtetë, për shkak të frikësimit apo burgosjes së pjesës më të madhe të kundërshtarëve të mundshëm. Kështu, Putini do të bëhet lideri që ka udhëhequr më së gjati në Rusi në më shumë se dy shekuj.

Putini u tha mbështetësve se ai i konsideron zgjedhjet demokratike dhe hodhi poshtë përpjekjet e atyre që protestuan ndaj këtij procesi zgjedhor. “Kemi shumë punë për të bërë, por kur ne jemi të konsoliduar, pavarësisht se kush dëshiron të na frikësojë, të na shtypë - askush nuk ia ka dalë mbanë ndonjëherë në histori; nuk ia kanë dalë mbanë tani dhe nuk do t’ia dalin mbanë



ndonjëherë në të ardhmen”, tha Putin.

Zgjedhjet treditore që filluan të premten për të zgjatur më tej sundimin 24-vjeçar të zotit Putin u zhvilluan në një mjedis të kontrolluar rreptësisht, ku nuk u

lejua asnjë kritikë ndaj zotit Putin apo luftës që ai filloi në Ukrainë. Rezultatet nga Komisioni Qendror Zgjedhor tregojnë se Putin mori 87 % të votave.

Agjencia e lajmeve Reuters raportoi se kandidati komunist

Nikolai Kharitonov u rendit i dyti me vetëm 4 % të votës, kandidati i ri në politikë Vladislav Davankon u rendit i treti dhe ultranacionalisti Leonid Slutsky i katërti. “Është e qartë se zgjedhjet nuk janë as të lira dhe as të ndershme, duke pasur parasysh se si Putini ka burgosur kundërshtarët politikë dhe ua ka ndaluar të tjerëve të kandidojnë përballë tij”, tha nga Shtëpia e Bardhë zëdhënësi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, sipas agjencisë së lajmeve Reuters. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy tha në fjalimin e tij mbrëmjen e së dielës se Putini është bërë “i sëmurë pas pushtetit”. “Nuk ekziston asnjë lloj ligësie që ai nuk do ta bënte për ta zgjatur pushtetin personal”, tha Zelenskyy. Sekretari i Jashtëm britanik David

Cameron kritikoi zgjedhjet të cilave u “mungonin alternativat për votuesit”, si dhe asnjë lloj monitorimi i pavarur nga Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE). “Nuk janë të tilla zgjedhjet e lira dhe të ndershme”, ka shkruar Cameron në rrjetin “X”.

Kina përgëzoi Putinin për fitoren e tij, duke nënvizuar marrëdhëniet strategjike mes dy vendeve. “Besojmë se nën udhëheqjen strategjike të presidentit Xi Jinping dhe të presidentit Putin, marrëdhëniet Kinë - Rusi do të vazhdojnë të përparojnë”, tha zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtme kineze, Lin Jian, kur u pyet për zgjedhjet në Rusi. Udhëheqësit e Koresë së Veriut, Hondurasit, Nikaraguas dhe Venezuelës, gjithashtu përshëndetën fitoren e Putinit.

Escobari gjatë vizitës në Kosovë takoi familjen e heroit Afrim Bunjaku

PRISHTINË, 18 MARS - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, njëherësh i dërguari për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, gjatë vizitës në Kosovë, ka takuar djemtë e rreshterit të vrarë të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, të cilët shoqëroheshin nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha. Escobari në prani të ambasadorit të ShBA-së, Jeffrey Hovenier dhe atashut të DOJ-

ICITAP-it, Kimberly Riffe, shprehu ngushëllimet e tij të singerta familjes për humbjen tragjike të babait/bashkëshortit të tyre. Ngjarja ishte shumë emocionuese dhe e përzemërt dhe personalitetet e larta i shprehën ngushëllimet e tyre familjes dhe Policisë së Kosovës. Në një takim të veçantë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, informoi Escobarin dhe atashut Riffe për sulmin ndaj policisë në Banjskë më 24

shtator 2023, ku mbeti i vrarë rreshteri Bunjaku dhe situatën aktuale të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës. Escobari vlerësoi mundësinë për të komunikuar drejtpërdrejt me kreun e Policisë së Kosovës. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, përcolli mirënjohjen e tij të thellë për Shtetet e Bashkuara dhe stafin e shumtë të ambasadës që ndihmojnë policinë dhe janë të përkushtuar për ta vazhduar bashkëpunimin e tyre të shkëlqyer.



“FAZ”: Rikthimi i Trumpit mund t’i hapë rrugë shkëmbimit të territoreve

PRISHTINË, 18 MARS - Rikthimi i Donald Trumpit në krye të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), duke marrë për bazë edhe trashëgiminë kontroverze të ish-emisarit Special të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Richard Grenell, mund të ketë pasojë të mëdha për rajonin, posaçërisht për shtetin e Kosovës. Ky është vlerësimi i prestigjiozes gjermane “Frankfurter Allgemeine Zeitung” në një artikull kushtuar projektit potencial të investimeve të dhëndrit të ish-presidentit amerikan, Jared Kushner, në Shqipëri dhe Serbi. Në artikullin e “FAZ”-it përmendet ideja e moçme e shkëmbimit të territoreve Kosovë - Serbi. Autori i artikullit, Michael Martens, përmend një “marrëveshje të



planifikuar” ndërmjet kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe presidentit

të atëhershëm të Kosovës, Hashim Thaçi, për ndarjen e Kosovës në vija etnike, por që u parandalua atëherë.

“Rama, Vuçiqi dhe Thaçi ishin në prag të ndarjes së Kosovës. Në bazë të një marrëveshjeje të planifikuar atëherë që u quajt ‘shkëmbim territorësh’, veriu i Kosovës do t’i kishte rënë Serbisë dhe jugu do të kishte tendencë drejt Shqipërisë”, shkroi gazetari gjerman, i cili mbulon zhvillimet në rajon. “Për Ramën dhe Vuçiqin, mbështetja e dëshirave të këtylla mund të jetë e dobishme politikisht nëse Trumpi bëhet sërish president [...] marrëdhëniet e mira me presidentin e mundshëm të ardhshëm të ShBA-së mund t’i hapin rrugën Ramës dhe Vuçiqit për t’i rinovuar planet e tyre”, pretendoi ai. Administrata Trumpit sugjeroi negociimin mbi një parim të ri: një këmbim territorësh ku të dyja palët

do t’i rishikonin kufijtë e tyre përgjatë vijave etnike duke transferuar pjesën me shumicë serbe të veriut të Kosovës në Serbi në këmbim të një pjese me shumicë shqiptare të Serbisë jugore në Kosovë. Pas rikonstruktimit të forcave në ShBA, përgjegjësia i kaloi BE-së. Në pjesën veriore të Kosovës, komunat e banuara kryesisht me serbë etnikë, përpigën të mbajnë një sistem paralel të përkrahur dhe financiar nga Serbia, ndërsa perspektiva e ndarjes apo këmbimit të territoreve ngrihet herë pas here në debatet publike. E idenë e ripërcaktimit të kufijve në vija etnike e kanë dhënë edhe shumë diplomatë e studiues perëndimorë, transmeton albanianpost.

Cramoni: Qeverisë së Kosovës i mungon vullneti politik për të bërë përparim në rrugën e integritimeve evropiane

PRISHTINË, 18 MARS - Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE), Viola von Cramon, në një intervistë për agjencinë bullgare të lajmeve të hënën, nëpërmjet toneve qortuese, vlerësoi se Qeverisë së Kosovës i mungon vullneti politik për të bërë përparim në rrugën drejt integritimeve evropiane, derisa komentoi disa procese nëpër të cilat është duke kaluar vendi tash e sa kohë. Cramoni theksoi se për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE), vendin e vogël ballkanik duhet ta njohin 27 shtetet

anëtare të bllokut, duke veçuar faktin se pesë prej tyre refuzojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës aktualisht - Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qipro - duke mos harruar përmbushjen e obligimeve në kuadër të dialogut Prishtinë - Beograd. “Të gjithë pajtohen se ka nevojë për përfundim të suksesshëm të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Beograd - Prishtinë. Do të ishte shumë më e lehtë për të gjithë nëse Kosova do të thoshte se i ka përmbushur të gjitha kërkesat dhe i plotëson të gjitha



kriteret, atëherë BE-ja dhe partnerët ndërkombëtarë do të ushtrojnë presion të madh ndaj Serbisë”. Ajo komentoi edhe rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), nëpërmjet së cilës përcaktohet euro

si e vetmja valutë ligjore që lejohet për transaksione me para të gatshme në Kosovë, duke ndaluar përdorimin e dinarit serb brenda territorit të Kosovës. Cramoni u shpreh e pakënaqur me mënyrën se si ekzekutivi i Kosovës tentoi ta zbatonte vendimin. “Kosova si shtet sovran ka të drejtë të vendosë se cilën valutë do të përdorë, por mënyra se si u përpoq ta zbatonte vendimin është problematike. Ata nuk informuan personat që do të preken; ata nuk dhanë informacione në serbisht për vendimin dhe nuk bënë

konsultime. E gjithë kjo ishte kundër interesave të njerëzve të zakonshëm”, argumentoi eurodeputetja. Derisa vendet nga Ballkani Perëndimor anëtarësimin në BE e përjetojnë sikur njëfarë kthimi në kontinentin evropian, shumë nga shtetet perëndimore anëtare kanë një qëndrim skeptik, posaçërisht ndaj një rajoni të rrethuar nga armiqësitë etnike. Arsytet për këtë distancë janë të ndryshme, por kryesor është fakti se nuk duan të pranojnë në bllok shtete problematike.

Mbi 46 mijë qytetarë me të drejtë vote në katër komunat veriore

PRISHTINË, 18 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar raportin jopërfundimtar të Listës së Votuesve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, raporton Ekonomia Online. Sipas këtij raporti, numri jopërfundimtar i qytetarëve me të drejtë vote në këto

komuna është 46,248 votues apo 1 153 votues më shumë në krahasim me zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune të cilat janë mbajtur më 23 prill 2023, ndërsa numri i përgjithshëm i Qendrave të Votimit është 44. Me qëllim të funksionalizimit të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në këto katër komuna janë caktuar zyrtarët ekzekutivë të cilët, njëkohësisht, janë kryesues të

KKZ-së. Lidhur me këtë, në vazhdim të mbledhjes, KQZ mori vendim për emërimin e rreth 20 anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, por që mund të plotësohet gjatë ditëve në vazhdim. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (2023), KKZ-ja administron zgjedhjet brenda komunës përkatëse në mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së.





Osmani thotë se çështja e dinarit serb në Kosovë duhet të zgjidhet urgjentisht

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se çështja e dinarit serb në Kosovë duhet të zgjidhet urgjentisht. “Është urgjente që kjo çështje të zgjidhet”, ka thënë Osmani në një konferencë për medie të hënën, pas një vizite në qytetin e Lipjanit. Ajo nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me deklaratimet e zyrtarëve amerikanë të cilët kanë përsëritur ditët e fundit se kanë probleme në komunikim me Qeverinë e Kosovës për shkak të mungesës së koordinimit. Megjithatë, ka thënë se çdo hap përpara që Kosova ka bërë, e ka bërë bashkë me aleatët euroatlantikë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHINË, 18 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se çështja e dinarit serb në Kosovë duhet të zgjidhet me urgjencë dhe se tashmë ekziston pajtueshmëri për një pjesë të propozimit amerikan për këtë çështje. Sipas saj, ideale do të ishte nëse do të arrihej një marrëveshje për të në Bruksel, më 19 mars, në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel të kryenegociatorëve.

Ajo ka thënë se është shumë pozitive “që komuniteti ndërkombëtar, në krye me Shtetet e Bashkuara, pajtohen mos të ketë qarkullim të dinarit në Kosovë”. “Me ndihmën e

tyre kemi arritur që tash e tutje ato dërgesa, ajo ndihmë financiare që vjen nga Serbia, të arrijë në euro dhe jo në dinarë, dhe kjo besoj që e zgjidh një pjesë të madhe të problemit me të cilin jemi ballafaquar në të kaluarën”, ka thënë Osmani në një konferencë për medie pas një vizite në qytetin e Lipjanit.

Sa i përket pjesës së dytë të propozimit, ajo ka thënë se janë duke shqyrtuar mënyra për të garantuar që ndihma që nisët prej Serbisë për komunitetin serb në Kosovë të mos keqpërdoret. “Të mos shkojë në duart e personave që kanë abuzuar, që janë korruptuar dhe i kanë marrë paratë kinse në emër të qytetarëve, por i kanë shfrytëzuar

për krim të organizuar. Për atë pjesë është duke u hartuar një plan që do t'i përfshijë autoritetet e Kosovës”.

Osmani ka thënë se ka shpresa që shumë shpejt do të arrihet pajtueshmëri edhe për pikën e dytë. “Është urgjente që kjo çështje të zgjidhet, sepse jo vetëm që u ndihmon qytetarëve që t'i tejkalojnë disa prej sfidave me të cilat ballafaqohen por. në të njëjtën kohë, të jemi shumë të sinqertë, Kosova ka probleme më të mëdha, ndër të tjera, probleme të sigurisë”, duke përmendur në veçanti nevojën e sigurimit të kufirit me Serbinë, e cila, sipas saj, analizon vazhdimisht mënyra për ta sulmuar Kosovën.

Prej 1 shkurtit Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka nisur të zbatojë një rregullore të re e cila përcakton që euroja është valuta e vetme në përdorim për kryerje të pagesave me para të gatshme.

Kështu është pamundësuar përdorimi i dinarit.

Zyrtarët amerikanë kanë përsëritur disa herë ditët e fundit se kanë probleme në komunikim me Qeverinë e Kosovës për shkak të mungesës së koordinimit. E pyetur për qasjen e qeverisë ndaj ShBA-së, Osmani ka thënë se mund të deklarohet vetëm për qasjen e saj si presidente me të gjitha institucionet brenda vendit, si dhe me partnerët ndërkombëtarë. “Republika e

Kosovës është shteti që ka lindur për shkak të sakrificës së popullit të Kosovës, luftës sonë çlirimtare, rezistencës shumëvjeçare dhe përkrahjes historike që kemi marrë nga aleatët... ne këtë nuk duhet ta harrojmë kurrë, sepse nuk ka qenë përkrahje e njëhershme, pra vetëm më 1999, por çdo hap përpara që Kosova ka bërë, e ka bërë bashkë me aleatët euroatlantikë”. Ajo ka thënë se punët e mëdha dhe të mira Kosova i ka bërë vazhdimisht me aleatët dhe një qasje e tillë duhet të vazhdojë.

Gjatë konferencës për medie, Osmani është pyetur edhe për mungesën e zbatimit të marrëveshjes së arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë një vit më parë në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Atëbotë palët janë pajtuar për aneksin e zbatimit të një Marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve për të cilën palët janë marrë vesh në shkurt të po atij viti.

Osmani ka thënë se duhet të analizohen veprimet e palëve në terren “për të ardhur te një përfundim komplet objektiv”. “Serbia e ka shkelur me dhjetëra herë këtë marrëveshje, e cila qartë i kërkon që të mos e shkelë integritetin territorial të Kosovës, që ta njohë subjektivitetin ndërkombëtar dhe parimin e

barazisë së palëve, që të mos votojë kundër Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, që të mos përdorë dhunë në marrëdhëniet ndërshtetërore e shumë e shumë parime të tjera”, ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se në Bruksel është duke u hartuar tani një plan i zbatimit të marrëveshjes, pasi deri më tani nuk ka pasur pajtim të plotë të palëve, dhe se ajo vetë, si presidente, nuk është pajtuar me një plan të paraqitur prej zyrtarëve të Brukselit meqë, sipas saj, ishte paraparë që Serbia të përfitonte në fillim të zbatimit të planit, ndërsa Kosova në fund. “Kërkoj trajtim të barabartë të palëve, që plani sekuenues i zbatimit të ketë parasysh që si Kosova, si Serbia, t'i zbatojnë në mënyrë paralele obligimet e tyre, dhe jo që njëra palë t'i ketë të gjitha përfitimet në fillim, e pastaj për Kosovën të mendohet krejt në fund”, është shprehur Osmani.

Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel me ndërmjetësim të bllokut evropian qysh më 2011. Palët kanë arritur një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar. Kryediplomati evropian Josep Borrell ka përsëritur të hënën se dy vendeve do t'u ushtrohet presion ndërkombëtar për t'i zbatuar marrëveshjet e arritura deri më tani.

Borrelli paralajmëron vazhdimin e presionit për zbatimin e marrëveshjes Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 18 MARS - Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka thënë të hënën në Bruksel se do të vazhdohet presioni ndërkombëtar ndaj Kosovës dhe Serbisë, që t'i zbatojnë obligimet e tyre nga marrëveshja e arritur para një viti, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Borrelli i ka bërë këto deklarata duke folur para gazetarëve në prag të nisjes së takimit ministror të Këshillit të Punëve të Jashtme të BE-së. Edhe këtë herë, Borrelli ka shprehur keqardhje se një vit pas arritjes së Marrëveshjes së Ohrit, niveli i zbatimit të saj nga palët ka qenë shumë më i vogël sesa që ai kishte pritur. Ai i është referuar pajtueshmërisë në mes të Kosovës dhe Serbisë për aneksin e një marrëveshjeje, për të cilën palët u patën marrë vesh në shkurt të vitit të kaluar në Bruksel. “Sot është përvjetori i parë i Marrëveshjes së Ohrit. Koha po fluturon dhe tashmë është bërë një vit prej kur kishim arritur marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë në mënyrë që ato të lëviznin përpara drejt normalizimit. Për fat të keq, përkundër mbështetjes së gjerë ndërkombëtare dhe të Bashkimit

Evropian, Serbia dhe Kosova kanë arritur shumë pak përparim”, ka thënë Borrelli para gazetarëve, duke paralajmëruar edhe takimin e radhës në kuadër të dialogut në nivelin e kryenegociatorëve. “Së shpejti do ta kemi takimin tjetër të kryenegociatorëve këtu në Bruksel. Më vjen keq se kjo marrëveshje, e cila ishte shumë vështirë të arrihej, nuk është zbatuar. Do të vazhdojmë të bëjmë presion ndaj të dyja palëve në mënyrë që të lëvizin përpara. Por, një vit më vonë, zbatimi nuk ka qenë aq sa unë kisha pritur të jetë”, ka thënë shefi i diplomacisë së BE-së. Ai ka bërë komente të ngjashme edhe të dielën në një komunikatë të lëshuar nga zyra e tij në përvjetorin e Marrëveshjes së Ohrit. Ndërkohë, për të martën në Bruksel është paralajmëruar takimi i radhës në kuadër të dialogut, ku Kosova dhe Serbia do të përfaqësohen nga kryenegociatorët. Nga Kosova pritet të marrë pjesë zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, ndërsa delegacionin e Serbisë e udhëheq drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković. Bashkimi Evropian ka paralajmëruar se në këtë takim do



të diskutohet për gjetjen e një zgjidhjeje rreth përdorimit të valutës në Kosovë si dhe për çështjet e tjera urgjente, përfshirë edhe zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve. Vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës - për të zbatuar një rregullore që përcakton euron si valutën e vetme për kryerje të pagesave me para të gatshme - është konsideruar si “ndalim i

dinarit të Serbisë” dhe është kritikuar nga bashkësia ndërkombëtare si “vendim i njëanshëm, i pakoordinuar dhe i pakomunikuar paraprakisht”. Sipas BE-së dhe Shteteve të Bashkuara, ky vendim ka shkaktuar probleme praktike për disa komunitete në Kosovë të cilat marrin asistencë financiare nga Serbia. Në kërkim të një zgjidhjeje, javë më

parë në Bruksel është zhvilluar një takim ku nga Kosova mori pjesë delegacioni i BQK-së, por jo edhe i Qeverisë së Kosovës. Qeveria e Kosovës ka insistuar se kjo nuk është një çështje politike, por është kompetencë e BQK-së si një institucion i pavarur financiar. Por, në BE konsiderojnë se për shkak të pasojave praktike dhe politike, edhe kjo çështje duhet të zgjidhet përmes dialogut.

Pjesëmarrja e Bislimit në takimin e Brukselit, PDK-ja: Çështja e dinarit është vetëm një segment i vogël i kësaj adoleshence politike



PRISHTINË, 18 MARS - Bashkimi Evropian ka konfirmuar se të martën në Bruksel do të mbahet takimi në nivel kryenegociatorësh, ku pjesë e diskutimeve do të jetë edhe çështja e rregullores së re të Bankës Qendrore të Kosovës, që ndalon qarkullimin e dinarit. Pjesëmarrjen në takim e ka konfirmuar edhe zëvendëskryeministri Besnik

Bislimi. Por, diskutimi i rregullores së BQK-së, në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, po kundërshtohet nga partitë opozitare në vend. Faton Abdullahu nga Partia Demokratike e Kosovës ka thënë se partia e cila tashmë është në pushtet deri dje i ka gjykuar ata që kanë biseduar me Vuçiqin. “Asgjë e re nga kjo mendësi politike,

popullizëm gjithandej, taktizime me simbolika patetike e regresive, pa strategji largpamëse progresive. Kjo mendësi, dje opozitare, ka hedhur gur e dru, ka vërë zjarr dhe shpall tradhtarë të gjithë ata që janë gjykuar të ulen e të bisedojnë me Vuçiqin”, është shprehur Abdullahu për “Telegraf”-in. Ai deklaroi se çështja e dinarit është vetëm një segment i vogël,

siç e quajti ai, “adoleshencë neverike politike”. “Sot të njëjtit, tash në pushtet me kollare, jo vetëm që ulen me Vuçiqin, por flasin për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë e nuk flasin për njohjen e Kosovës shtet. Çështja e dinarit është vetëm një segment i vogël i kësaj adoleshence nevrrike politike, e cila në mungesë të maturimit politik

na ka degraduar deri aty sa tash sa kohë jemi nën sanksione nga ata me të cilët kemi bërë rrugëtimin më të suksesshëm në historinë tonë”, pohoi ai. Abdullahu theksoi se zgjedhjet janë zgjidhja, duke shtuar “sa më parë aq më mirë për të gjithë e sidomos për kualitetin e jetës së qytetarëve e cili po degradon pandalshëm dhe gjithanshëm”.

"Xixëllonjat" në lagjen Pejton, së shpejti me sistem të ri të ngrohjes

PRISHTINË, 18 MARS- Brenda dy javësh, kopshti "Xixëllonjat", në lagjen Pejton të Prishtinës do të jetë me sistem të ri të ngrohjes, kjo falë "Termokos"-it.

Këtë lajm e bëri të ditur në një postim në "Facebook", kryeshefi ekzekutiv i ngrohtores "Termokos", Fisnik Osmani. Osmani së

bashku me përfaqësuesit komunal të Komunës së Prishtinës vizituan punimet që janë në fazën finale për kycjen e kopshtin të fëmijëve "Xixëllonjat" në sistemin e ngrohjes.

Kopshti është një vend ku krijohen miqësi, krijohen kujtime dhe gëzimi i të mësuarit festohet çdo ditë

dhe prandaj përkujdesja për shëndetin e arsimit cilësor të fëmijëve është prioritet.

"Termokos"-i po bën një ndikim pozitiv në kryeqytet, duke sjellë ngrohtësi dhe qëndrueshmëri në komunitet ndërsa vazhdojnë të sjellin inovacion dhe të krijojnë një Prishtinë të gjelbër.



Sfidat e sigurimit të mbrojtjes të të dhënave personale në komunë, temë diskutimi në mes të Lladrovci dhe Dërmakut



DRENAS, 18 MARS - Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur të hënën në takim komisionaren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dërmaku, drejtoreshën e përgjithshme, Lumnije Demi dhe Nita Zeqiri, me ç'rast diskutuan për arritjet dhe sfidat e sigurimit të mbrojtjes së të dhënave personale në komunë. Në takim morën pjesë edhe zyrtarët e komunës të cilët kanë të bëjnë me komunikimin publik dhe çështjet që lidhen me sigurinë e të dhënave personale.

Sogojeva-Dërmaku ofroi bashkëpunimin e plotë për realizimin e objektivave të përbashkëta, në kuadër të kornizës ligjore, duke theksuar bashkëpunimin e shkëlqyer të deritashëm, në mes të Agjencisë dhe komunës së Drenasit. Kryetari Lladrovci e ka falënderuar komisionaren Sogojeva-Dërmaku për përkushtimin e agjencisë, si krah i fortë i zbatimit të ligjshmërisë, duke theksuar se planifikojnë ta bëjnë digjitalizimin e komunës, për ta avancuar transparencën, sigurinë dhe informimin e

qytetarëve të komunës së Drenasit.

Po ashtu, Lladrovci ka theksuar nivelin maksimal të transparencës, gatishmërinë e ofrimit të qasjes në dokumente zyrtare për qytetarët, qasjen për mediet dhe palët e interesuara, duke potencuar ankesat tona pranë KMSHK-së, si dhe vonesat rreth trajtimit të shpifjeve.

"Transparenca është baza e qeverisjes demokratike, privatësia e qytetarit, ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave të qytetarëve, është obligim yni dhe qëndrojmë fort pas kësaj", ka thënë Lladrovci.

Nënkryetari i Rahovecit përcjell procesin e aplikimit të fermerëve për pagesa direkte/subvencione për vitin 2024

RAHOVEC, 18 MARS - Nënkryetari i komunës së Rahovecit, Fatmir Iska, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të kryetarit, Ali Morina, ka vizituar zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për ta parë procesin e aplikimit të fermerëve për pagesa direkte/subvencione për vitin 2024, për 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore.

Gjatë kësaj vizite u tha se komuna e Rahovecit i ka bërë të gjitha përgatitjet për këtë proces të rëndësishëm, duke i hapur zyrat për aplikim edhe në Krushë të Madhe dhe Ratkoc. Pranimi i aplikacioneve për sektorët të cilët do të mbështeten përmes programit për pagesa direkte për vitin 2024 është i hapur deri më 12 prill 2024 në orën 16:00.



Presidentja Osmani nis vizitat nëpër komuna

Lipjan, 18 mars - Presidentja Vjosa Osmani ka nisur vizitat nëpër komuna. Ajo të hënën ka vizituar komunën e Lipjanit dhe është pritur nga kryetari Imri Ahmeti. Me këtë rast, Osmani ka thënë se nga puna e kryetarit Imri Ahmeti, lipjanasit kanë me çfarë të krenohen.

Komunën e Lipjanit, Osmani e konsideron ndër komunat që ka ofruar mundësi të jashtëzakonshme për biznese. "Ne sot me Lipjanin po i vazhdojmë vizitat nëpër komuna. Ahmeti është një prej kryetarëve që njihemi më se 20 vjet. Nga puna e tij e deritanishme, qytetarët e Lipjanit

jam e bindur se kanë me çfarë të krenohen. Është komunë që ka ofruar mundësi të jashtëzakonshme për biznese. Janë mbi dy mijë biznese që operojnë këtu. Biseduam edhe për investitorët e jashtëm", ka treguar Osmani.

Më 15-16 prill, Prishtina nikoqire e Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

PRISHTINË, 18 MARS - Më 15-16 prill Prishtina do të jetë nikoqire e përfaqësuesve nga rajoni dhe bota në Forumin

Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Me mbi 100 panelistë në dhjetëra panele diskutimi me

temën "Ridefinimi i Sigurisë", edicioni i dytë do të fokusohet në parandalimin e dhunës seksuale gjatë luftës si dhe

garantimin e sigurisë për gratë dhe vajzat gjersa përballen me sfidat e shkaktuara nga ndryshimet klimatike.



“KPK-ja të sigurojë përfaqësim gjinor me zgjedhjen e anëtarit të ri nga radhët e PSRK-së”

PRISHTINË, 18 MARS - Organizatat joqeveritare IKD, FOL dhe INPO i bëjnë thirrje Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), që në përputhje me kompetencat që ka, ta garantojë përfaqësimin gjinor në përbërjen e KPK-së me rastin e votimit për anëtarin e ri të Këshillit nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK).

KPK-ja nga 27 marsi 2024 do të mbetet vetëm me dy anëtare gra në përbërjen e vet, pasi anëtares aktuale Merita Bina-Rugova i përfundon mandati më 27 mars 2024. Ajo në këtë pozitë ishte zgjedhur më 27 mars 2019.

IKD, FOL dhe INPO i bëjnë thirrje KPK-së ta respektojë Ligjin për KPK-në dhe Rregulloren përkatëse për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë, me qëllimin e vetëm që të sigurohet përfaqësimi gjinor siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.

Sipas Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, [neni 9, paragrafi 4], është përcaktuar se: “Anëtarët e Këshillit pasqyrojnë natyrën shumetnike dhe parimet e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës dhe zgjedhën bazuar në kompetencën, përvojën dhe njohurinë e tyre”. Pra, sipas këtij

Ligji, përbërja në KPK duhet t'i pasqyrojë parimet e barazisë gjinore.

Sipas këtyre tri organizatave, edhe sipas Rregullores përkatëse, konkretisht [Neni 5, par.2], Këshilli duhet të kujdeset dhe t'i bëjë vlerësimet paraprake mbi nivelin e përfaqësimit gjinor.

Tutje, paragrafi 3 i po këtij neni ka paraparë se: “Nëse ka aplikues nga komunitetet joshumicë ose të gjinisë femërore, KPK-ja do të angazhohet të sigurojë që në përbërjen e saj të ketë së paku një (1) anëtar nga komunitetet joshumicë dhe së paku tre (3) anëtarë të gjinisë femërore”.

Sipas rregullores përkatëse, kërkohet që në përbërjen e KPK-së minimumi të jenë tri anëtare të gjinisë femërore.

Po ashtu, [neni 8, par. 15] i Rregullores përkatëse ka përcaktuar se: “Nëse KZ i KPK-së konstaton se përfaqësimi i tillë gjinor dhe etnik nuk është arritur sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, atëherë KPK-ja do ta zbatojë rregullën sipas së cilës kandidatët femra apo kandidatët nga radhët e komuniteteve joshumicë që kanë numër më të lartë të votave në nivel të të gjitha prokurorive ku mbahen zgjedhjet në proporcion me



numrin e përgjithshëm të prokurorëve, zgjedhën me përparësi anëtarë të KPK-së. Në rast se kandidatët kanë vota të njëjta atëherë zgjedhja bëhet me short”.

KPK-ja në të kaluarën ka pasur situata të tilla të ngjashme, e ku veçroi në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kujtojmë se në zgjedhjet e zhvilluara në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, në tetor të vitit 2020, në votimin e dytë në garë kishin qenë prokurorët Jovo Radović dhe Naim Beka.

Prokurori Beka e kishte fituar besimin e prokurorëve me 11 vota, ndërsa prokurori Radović kishte marrë vetëm 9 vota. Megjithatë, edhe pse humbës i zgjedhjeve, prokurori Radović

ishte zgjedhur anëtar i KPK-së, për faktin e arritjes së qëllimit të përfaqësimit etnik në KPK, pasi prokurori Radović vinte nga komuniteti serb. Për më tepër, kryesuesi i asaj kohe i KPK-së, Bahri Hyseni, i kishte kërkuar ndjesë Bekës i cili e kishte fituar garën, duke thënë se kështu përcaktohej me rregullore dhe se kjo, siç thoshte ai, është bërë praktikë edhe në mandatet e mëhershme të KPK-së.

Edhe Strategjia për Sundimin e Ligjit (2021-2026) dhe Plani i Veprimit të saj kishin kërkuar nga KPK-ja t'i zbatojë masat e politikave për sigurimin e përfaqësimit gjinor dhe etnik në përbërjen e saj. [Raporti Vjetor për Zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, mars 2023, fq.

18].

Po ashtu, sipas Raportit të Progresit për Republikën e Kosovës për vitin 2023, Republika e Kosovës ende ka një përqindje të ulët të grave gjyqtare dhe prokurore në krahasim me shumicën e vendeve të tjera evropiane.

Ndryshe, pabarazia gjinore më e theksuar shprehet në pozitat udhëheqëse. Përqindja e grave në pozitat udhëheqëse nuk është ekuivalente me përqindjen e përgjithshme të grave prokurore në sistemin e drejtësisë. Kjo pasi, nga dhjetë pozita të kryeprokurorëve në vend, pozitën e kryeprokurorëve e mbajnë vetëm prokurorët burra. Pra, asnjë nga to nuk udhëhiqet nga gratë.

Mbi bazën e të lartcekurave, IKD, FOL dhe INPO i rekomandojnë KPK-së që me rastin e votimit për anëtarin e ri të KPK-së nga radhët e PSRK-së, ta zgjedhë prokuroren Habibe Salihu anëtare të re të KPK-së, në mënyrë që të sigurohet përfaqësimi gjinor së paku tri anëtare gra në përbërjen e KPK-së. Në të kundërtën, KPK do të veprojë në kundërshtim me Ligjin për KPK, Rregulloren përkatëse, Strategjinë për Sundimin e Ligjit dhe me standardet dhe praktikën e krijuar nga vetë ajo deri më tani.

PDK-ja shtrihet në të gjithë Belgjikën, themelon nëntë nëndegë brenda dy javëve



PRISHTINË, 18 MARS - Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në kuadër të shtrirjes dhe fuqizimit të saj në mërgatë, ka pasur aktivitet të

shtuar në shtetin e Belgjikës. Së fundmi, PDK-ja ka themeluar edhe tri nëndegë të reja në këtë shtet, duke e rritur në nëntë numrin e

nëndegëve të themeluara në dy javët e fundit. Atje u themeluan nëndega e Antwerpit, ku kryetar u zgjodh Hamit Bajra, nëndega

e Bryzhit, ku kryetar u zgjodh Adonis Shala dhe nëndega e Aalst, ku kryetar u zgjodh Ibush Suma. Të pranishmit i kanë

përshëndetur anëtarin e kryesisë së PDK-së, Zenun Pajaziti dhe kryetari i Këshillit për Degën e Belgjikës, Jetlir Llugani.

BQK-ja nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në fushën e edukimit financiar me përfaqësuesit e sektorit financiar

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 MARS - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit në fushën e edukimit financiar me përfaqësuesit e sektorit financiar: Shoqatën e Bankave të Kosovës (ShBK), Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK) dhe Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS).

Nënshkrimi i këtij memorandumi është bërë në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Parasë që po shënohet nga BQK-ja, e përcjellë me aktivitete të shumta në kuadër të edukimit financiar.

Qëllimi i këtij memorandumi është avancimi i gjithëpërfshirjes dhe vendosjes së bashkëpunimit në fushën e edukimit financiar, në mënyrë që të ketë aktivitete të koordinuara dhe bashkërenduara të edukimit si një përgjegjësi e përbashkët



midis shumë palëve të tjera të interesit.

Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, ka theksuar se institucioni që ai drejton do ta ketë në fokus edukimin financiar, me qëllim të

promovimit të qasjes dhe gjithëpërfshirjes në financa të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. “BQK-ja do ta ketë në fokus edukimin financiar me qëllim të qasjes në financa dhe promovimin e

gjithëpërfshirjes financiare në bashkëpunim me institucionet relevante”, ka theksuar guvernatori Ismaili, duke shtuar se bota po ndryshon shpejt. “Ndryshimet e avancuara të teknologjisë

informative dhe transformimit digjital, rreziqeve kibernetike, ndryshimet mjedisore e sociale, janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë e ne duhet të përgatitemi të përballemi me to”, ka thënë Ismaili.

Marrëveshja do të nxisë dhe promovojë iniciativa, ngjarje, aktivitete dhe materiale nga fusha e edukimit financiar (jokomerciale) përmes institucioneve të përfshira. Do të kontribuojë në organizime që rritin njohuritë e qytetarëve mbi produktet dhe shërbimet bankare e të sigurimeve dhe produktet/shërbimet e tjera financiare dhe informimin e qytetarëve.

Përmes edukimit financiar dhe Javës Ndërkombëtare të Parasë, synohet të avancohen njohuritë edukative financiare, me qëllim të përmirësimit të njohurive për çështjet ekonomike dhe financiare për të gjitha grupmoshat e shoqërisë sonë, duke filluar nga fëmijët dhe të rinjtë, për konsumatorët individualë e deri te ndërmarrësit.

Dy projekte në rrjetin energjetik janë duke u kryer në Ruhot të Pejës



Pejë, 18 mars - Dy projekte në rrjetin energjetik janë duke u kryer në tensionin e ulët dhe të mesëm nga ekipi i mirëmbajtjes në fshatin Ruhot të Pejës. Natyrës së bukur të këtij fshati buzë Drinit të Bardhë, investimet e KEDS-it po ia rritin bukurinë edhe më tepër.

Ekipi prej 13 punëtorëve po punon intensivisht në Ruhot dhe për disa ditë pritet ta përfundojë edhe projektin e dytë këtu, ku banorët e këtij fshati do të kenë një rrjet krejtësisht të ri energjetik dhe kështu do të zhduket përgjithmonë rrjeti i vjetër.

Një trafo të re me kapacitet 250 kVA ka ndërtuar KEDS-i dhe ka rikonstruktuar edhe dy trafo të tjera ekzistuese në fshat. Gjatë kryerjes së këtij projekti janë vendosur gjithsej 41 shtylla betoni të tensionit të mesëm dhe 27 shtylla të tensionit të ulët. Gjithashtu, janë shtrirë kablllo elektrike në një gjatësi prej 4 000 metrave. Përfitues të projektit do të jenë konsumatorët e këtij fshati.

Realizimi i këtij projekti do ta

rregullojë rrjetin e tensionit të ulët si dhe instalimin e sistemit PLC në fshat. “Shumë projekte investive kanë përfunduar në rajonin e Pejës edhe nga ekipet e mirëmbajtjes së KEDS-it dhe shumë të tjera priten të realizohen”, thotë koordinatori i Mirëmbajtjes në Distriktin e Pejës, Xhafer Tishukaj. “Vetëm vitin e kaluar janë 10 projekte investive që i kemi realizuar në Distriktin e Pejës përmes ekipeve të mirëmbajtjes. Vlen të përmendim projektet Maja e Zezë, Qallapeku, Ozdrim, Kulla, LP 10 kV Kastrati, Gllareva, Krusheva e Madhe etj. Tash jemi në procedura për ta filluar punën në projektin e Loxhës”, shton ai.

Pos investimeve përmes ekipeve të mirëmbajtjes, KEDS-i po realizon shumë projekte të tjera edhe përmes kontraktorëve.

Investimet e fuqishme po bëjnë që rrjeti në pjesën perëndimore të rrjetit të modernizohet dhe të ofrojë shërbime shumë të sigurt dhe me kualitative për konsumatorët e asaj ane, njëjtë sikurse edhe në tërë territorin e vendit.

Kontrollet për identifikimin e punës së padeklaruar vazhdojnë në Gjakovë

GJAKOVË, 18 MARS - Grupet e inspektorëve të ATK-së dhe Inspektoratit të Punës, shoqëruar nga zëvendësministri Agon Dobruna, drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, Ilir

Murtezaj, dhe kryeinspektori i IP-së, Hekuran Nikçi, kanë vizituar biznese në sektorët e gastronomisë dhe të ndërtimtarisë.

Ministria e Financave ka

njoftuar se inspektimet e përbashkëta do të vazhdojnë edhe në ditët në vazhdim. “Ftojme punëdhënësit që të deklarojnë punëtorët e tyre, ndërsa punëtorët i ftojme që të

lajmërojnë punëdhënësin e tyre në rast se ky i fundit ka të angazhuar punëtorë të paformalizuar dhe pa kontrata pune”, ka njoftuar Ministria e Financave.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (5)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-7-

Konfidenciale

GPS 240
Fm Washington 072350Z, prill ‘81
Për FCO rutinë
Telegram nr. 1143, datë 7 prill
Dhe për Beogradin

Jugosllavia: Kosova

1. Sipas udhëzimeve të Stoessel, Barry që është zëvendësasistent sekretar i Zyrës Evropiane të Shtetit, na tregoi sot mbi atë që amerikanët kishin dijeni për çështjen në Prishtinë. Ai nuk tha ndonjë gjë më shumë se Dolanc në konferencën e tij për shtyp dje.
2. Reagimi i policisë ka qenë i rreptë dhe më pas Beogradi ka përforcuar masat e sigurisë. Dukej tashmë se Jugosllavia kishte kontrollin në dorë. Megjithatë, shteti ka nxjerrë një njofum zyrtar mbi udhëtimet ku rekomandonte që të mos udhëtohej për në Kosovë. Barry komentoi se jugosllavët ishin qartazi të predispozuar që të vinin gishtin tek influenca e jashtme si burim i trazirave dhe aludonin se pas gjithë kësaj mund të ishte BRSS-ja. Amerikanët nuk kishin prova për të mbështetur këtë pretendim dhe ishin më të prirur që ta shikonin këtë si një djegie spontane që e kishte origjinën në vështirësitë ekonomike dhe pakënaqësitë e pakicës shqiptare. Jugosllavët do të përpiqeshin që të ruanin dhe zhvillonin “marrëdhëniet strategjike” me Shqipërinë.
3. Mbase për ju këto janë të njohura, por dimensionin rus ishte i panjohur për ne. Ne dinim vetëm se Dolanc nuk e përjashtonte mundësinë e përfshirjes së huaj në konferencën e tij për shtyp. Ambasada jugosllave këtu, në kontakte me zyrën e kancelarit, pohonte se shkaku kryesor ishte vetëm aspekti ekonomik dhe ai i pakicës shqiptare.

Henderson
[Ky telegram nuk është përcjellë]

-8-

Për përdorim të kufizuar
Z. Fergusson, 9 prill 1981

Çështja e Kosovës

1. Keni pyetur nëse në zhargonin jugosllav, termi “informbyroist” nënkupton sovjetik. Termat “kominformist” dhe “informbyroist” janë emra kode të këmbyeshme për

elementët prosovjetikë në Partinë jugosllave. Në fakt, as ne dhe as amerikanët nuk kemi gjetur ndonjë provë që të tregojë se sovjetikët kanë gisht në trazirat e kohëve të fundit.
2. Zyra e Kabinetit do të nxjerrë sot më vonë një vlerësim aktual të situatës në Kosovë.

J. C. R. Gray
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore

-9-

Konfidenciale

GR 650
Fm Beograd 091450Z, maj
Për FCO
Kopje origjinale
Nr. tel. 049, datë 9 prill 81
13 prill 1981
Informacion për UKDEL NATO
Kopje për Washington (FCO PSE PASS)
Telegrami im, nr. 45

Kosova

1. Siç mund të jetë pritur, Shqipëria ka kundërshtuar deklaratat e bëra nga udhëheqësit jugosllavë, të cilët ngjarjet e Kosovës ia atribuojnë kryesisht nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, dhe ka reaguar përmes një kryeartikulli kritik në gazetën “Zëri i Popullit”, i datës 8 prill, i transmetuar edhe në Radio Tirana (natyrisht teksti ju është vënë në dispozicion nga BBC). Jugosllavët janë kundërpërgjigjur me shpejtësi përmes një kryeartikulli në gazetën e sotme “Rilindja”, gazeta kryesore e Kosovës, ku artikulli përkatës është riprodhuar edhe në gazeta të tjera.
2. Kritika e Shqipërisë është në disa vende jashtëzakonisht provokative dhe jugosllavët iu përgjigjen me zemërim: tjetërkund ajo prek një numër pikash të ndjeshme të cilat përgjigja e jugosllavëve ose i prek përkritazi ose i injoron krejtësisht.
3. Shqiptarët përsëritën pyetjen e bërë në disa nga parullat e demonstruesve se përse burimet natyrore të Kosovës po shfrytëzoheshin në dobi të tjerëve, ndërkohë që Kosova kishte mbetur e prapambetur dhe e harruar. Jugosllavët u kundërpërgjigjen me sugjerimin se problemi i shqiptarëve ishte se ata i shqetësonte lulëzimi i Kosovës.
4. Mbështetja e gazetës “Zëri i Popullit” për ngritjen e Kosovës në statusin e Republikës në kuadrin e Federatës, irritoi gazetën “Rilindja” të

përgjigje se mbrojtja e saj e “bën gjithkënd të dyshojë se Shqipëria është vetë nxitëse ose kazani ku po gatuhet dhe nxiten këto tendenca armiqësore”.
5. Gazeta “Rilindja” i përshkroi si farsë deklaratat solemne të shqiptarëve për stabilitet dhe pavarësi në Jugosllavi dhe vlerësoi se dëshira e tyre për “ruajtjen e miqësisë me popujt vëllezër të Jugosllavisë” ishte edhe qesharake edhe sulmuese, ndërsa gatishmëria e tyre për të ndihmuar “vëllezërit e tyre shqiptarë” tingëllonte më shumë si kërcënim sesa si gatishmëri për bashkëpunim. Me gjithë “sulmet e rënda” të shqiptarëve, gazeta “Rilindja” pohoi gatishmërinë e Jugosllavisë për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, megjithëse ushqente dyshime për sinqeritetin e anës tjetër.
6. Por, jugosllavët e kaluan në heshtje fjalimin moralizues të shqiptarëve se “udhëheqja jugosllave duhet të tregojë maturi dhe të studiojë problemet e brendshme të saj me korrektesë në vend që t’u japë leksione me bollëk të tjerëve për maturinë, zgjidhjen paqësore të konflikteve, të drejtat e njeriut, të drejtat e kombeve e kështu me radhë”. Gjithashtu, jugosllavët nuk arritën t’i përgjigjen justifikimit të shqiptarëve mbi të drejtën e tyre për të ngritur zërin kundër “dhunës dhe shtypjes ndaj vëllezërve tanë” me argumentin e cituar kaq shpesh nga Jugosllavia se çdo shtet duhet të jetë i lirë “për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtat e pakicave të tij kombëtare”.
7. Gazeta “Rilindja” i përmbloodhi “mesazhet” e shqiptarëve si “të papranueshme, të palejueshme dhe keqdashëse”.
8. Të dyja palët kanë përdorur gjuhë të fortë dhe ka të ngjarë që ky të jetë vetëm fillimi i rishfaqjes së fyerjeve në të cilat ishin përfshirë shpeshherë përpara se të fillonin përpjekjet për përmirësimin e marrëdhënieve të tyre rreth 18 muaj më parë. Ndërkohë organizatat socio-politike në Kosovë dhe gjetkë po mblidhen çdo ditë dhe inkurajojnë mesazhe mbështetjeje mbi vlerësimin e situatës nga ana e autoriteteve dhe masat e marra në përpjekje për të vërtetuar se pjesa më e madhe e popullsisë së Kosovës është e kënaqur dhe se shpërthimet e kohëve të fundit ishin vepër e vetëm një grupi të vogël të poshtërish që i përkisnin bindjeve të ndryshme politike.

Bolland
[Përsëritet sipas kërkesës]
[Ky telegram nuk është përcjellë]

-10-

Konfidenciale

A. E. Montgomery
Ambasada britanike
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Beograd
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit,
15 prill 1981
Inderuar Alan,

Kosova

1. Dy javë pas dhunës në Kosovë, më 1 prill, shtypi vazhdon të raportojë çdo ditë se jeta po i kthehet


normalitetit në këtë krahinë, megjithëse ka pasur raporte për trazira të tjera, më 2 dhe 8 prill. Shumica e xhamave të thyer të dyqaneve janë riparuar dhe copëzat e thyera janë hequr nga rrugët e Prishtinës. Njerëzit po i kthehen punës së tyre normale, megjithëse ka mbetur në fuqi ndalimi i tubimeve publike, ndërkohë që qarkullimi i trafikut ka filluar sërish. Forcat e sigurisë kanë mbetur në pikat strategjike. Shkollat fillore janë rihapur më 13 prill, megjithëse mësimi nuk ka filluar ende në shkollat e mesme; ndërkohë Universiteti është duke pastruar dëmet e shkaktuara dhe po përgatitet për të kryer provimet e pranverës. Regjistrimi kombëtar i popullsisë është kryer në shkallë të madhe, megjithëse, kur çmohet e nevojshme, është lejuar shtyrja e afatit në Kosovë.
2. Lidhja Socialiste e Kosovës sapo ka nxjerrë statistika “përfundimtare” për të korrigjuar zërat që qarkullojnë mbi humbjet dhe plagosjet e njerëzve në këtë ngjarje. Tetë demonstrues dhe një milic janë vrarë; katër anëtarë të forcave të sigurisë janë plagosur dhe 12 janë lënduar; dhe nga demonstruesit 55 janë plagosur dhe 75 të tillë janë lënduar. Këto numra duket se janë të ulët dhe zërat e ushqyer me këmbëngulje nga ambasadori shqiptar këtu sugjerojnë që këto numra janë disa herë më të lartë në të gjitha kategoritë.
3. Sidoqoftë, situata e përgjithshme nuk i është kthyer ende normalitetit dhe jehona e ngjarjeve vazhdon të tingëllojë në takimet e shumta (Lidhja Socialiste pretendon për 10,000 të tillë deri tani) të organizuara nga organizata të ndryshme socio-politike në krahinë dhe më gjerë. Vazhdon të shprehet mbështetja popullore në shkallë të gjerë për vlerësimin zyrtar të situatës dhe kundërmatat e marra. Ndërkohë, organet më të larta të Federatës dhe të Republikave dhe të Lidhjes së Komunistëve po e shqyrtojnë me kujdes situatën. Sipas raporteve të shtypit, ato janë përqendruar kryesisht në dënimin e shpërthimit të nacionalizmit dhe irredentizmit dhe në thirrjen për nxitjen sërish të vëllazërimit dhe unitetit, por një vend më vete po i jepet nxjerrjes së mësimave, veçanërisht në lidhje me dështimin e autoriteteve lokale për të vlerësuar me korrektesë seriozitetin e situatës dhe dështimin e komunistëve për të bërë detyrën e tyre jo vetëm për të ndaluar demonstratat, por gjithashtu edhe për të penguar njerëzit që të bashkohen me të! Sindikatat e Kosovës e pranojnë tashmë se një numër punëtorësh në Prishtinë, Podujevë, Mitrovicë dhe Ferizaj, janë përfshirë në mënyrë aktive për të ndihmuar organizatorët e demonstratave dhe se kundër tyre do të merren “masa konkrete”. Lidhja Socialiste në Kosovë e ka pranuar gjithashtu se ende vazhdojnë forma të ndryshme të aktivitetit armiqësor. Kështu, Kosova nuk e ka hedhur lumin akoma.
4. Ndoshta jeni informuar më mirë se unë mbi vërshimet e fundit të Radio Tiranës, por siç shihet që këtu,

parashikimet për të sharat e dyanshme të bëra në telegramin tonë nr. 49 të datës 9 prill, pa dyshim që vazhdojnë. Editoriali i “Zërit të Popullit” vazhdon të evokojë komente të reja në media. Asllan Fazlia, kryetar i Komitetit Qendror të Prishtinës, iu referua këtij artikulli dhe një tjetri në gazetën “Bashkimi”, e përshkruar si organ i Frontit Popullor Shqiptar, më 11 prill, kur foli për “mbështetjen e tyre të hapur për demonstratat, metodat e tyre, përmbajtjen dhe karakterin armiqësor”. Ai i përshkroi ato gjithashtu si “thirrje për kryengritje të hapur të popullit shqiptar në Kosovë” dhe i akuzoi ata se kanë ofruar vetëm “një sistem stalinist për të rregulluar marrëdhëniet shoqërore dhe kombëtare”. Ai i përmbloodhi ata “si dhënie e një mundësie ndaj forcave hegemoniste dhe të tjera për të rirregulluar botën. Kjo mund të mos jetë më në interesin e Jugosllavisë sesa në interesin e vetë Shqipërisë”.
5. Ndërkohë që vazhdon polemika politike, është me vlerë të thuhet se marrëdhëniet tregtare dhe kulturore ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë, vazhdojnë normalisht. Më 9 prill, Dhoma Jugosllave e Ekonomisë vlerësoi se volumi i tregtisë dypalëshe këtë vit do të arrinte në 135 milionë dollarë, d.m.th. 15 milionë dollarë më shumë se në vitin 1980. Më 8 prill, një grup akademikësh nga Tirana bënë një vizitë zyrtare në Titograd dhe nënshkruan një Marrëveshje bashkëpunimi. Më 10 prill, Akademia e Shkencave të Maqedonisë dhe ajo e Shqipërisë lidhën një marrëveshje për bashkëpunim në fushën shoqërore natyrore dhe atë të shkencave të zbatuara. Ata gjithashtu ranë dakord që bashkëpunimi të krijohej së pari në fushën e gjuhës, historisë, gjeografisë, arkeologjisë, etnologjisë dhe në historinë e të kaluarës së përbashkët të dy popujve. Kjo vizitë u krye në përgjigje të një vizite të tillë të bërë nga një delegacion maqedonas në Tiranë. Pritet të nënshkruhen marrëveshje zyrtare në shtator në Shkup.
6. Situata ka mbetur kështu e paqëndrueshme dhe do të duhet të presim edhe për pak kohë që të përpiqemi të vlerësojmë ngjarjet, shkaqet dhe pasojat e tyre në një mënyrë më të peshuar. Ndërkohë duket se autoritetet po përpiqen shumë për të kontrolluar situatën në krahinë dhe për të marrë masa të menjëhershme për të eliminuar keqbërësit dhe për të lehtësuar disa nga pikat e presionit, veçanërisht Universitetin e Prishtinës. Megjithëse vëzhguesit e huaj nuk lejohen ende të vizitojnë Kosovën, më shumë informacion po merret mbi ngjarjet që kanë ndodhur sesa mbi ndonjë trazirë të ngjashme në të kaluarën. Një gjë e tillë të paktën përbën progres.

I Juaji, T.J. Clark

Për dijeni: P. Rennie Esq, Zyra e Kancelarit
Departamenti i Kërkimit, Uashington
Zyra e Kancelarit
UKDEL NATO
Bruksel

(Vijon)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Aro Muriq në formacionin e javës në Premierë Ligë

BURNLEY, 18 MARS - Arijanet Muriq ka debutuar në elitën e futbollit anglez Premierë Ligë me fanellën e Burnleyt. Portieri nga Kosova ka qenë fantastik në debutimin e tij, duke bërë disa pritje dhe duke

i siguruar skuadrës fitoren 2-1 ndaj Brentfordit. Paraqitja e tij e jashtëzakonshme është vlerësuar lart, pasi portieri dardan është në formacionin e javës në Ligën Premierë.

Legjenda angleze Alan Shearer e bëri formacionin e javës në elitën e futbollit anglez dhe vendosi Muriqin në portë. Reprezentuesi nga Kosova është futur në formacionin e javës së 29, ku së

bashku me të janë Timo Castagne, Mengi, Robinson. Në mesfushë janë edhe Berry, Lukiq, Gibbs-White dhe Nicolo Zaniolo, ndërsa sulmi përbëhet nga Fofana, Muniz dhe Antonio.



Foda: Kosova ka ekip me lojtarë cilësorë, do të arrijë rezultate të mira

Kosova do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore me Armeninë dhe Hungarinë në këtë muaj, ndërsa përzgjedhësi Franco Foda shpreh optimizëm se do të arrijë rezultate pozitive me "dardanët". "Kosova ka lojtarë shumë interesantë, shumë të mirë. Jam shumë i magjepsur se do të arrijmë rezultate të mira", ka thënë Foda

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 MARS - Franco Foda e ka mbajtur konferencën e parë si përzgjedhës i Përfaqësueses së Kosovës në futboll. "Dardanët" do të zhvillojnë dy miqësore në këtë muaj me Armeninë dhe Hungarinë, ndërsa Foda ka ndarë detajet rreth procesit të zgjedhjes së lojtarëve dhe takimeve me ta. "Ky është grumbullimi ynë i parë. Gjatë javëve të kaluara unë së bashku me ndihmësit e mi kemi udhëtuar shumë. Kemi vëzhguar lojtarë dhe jemi njoftuar rreth paraqitjeve të tyre. Jam takuar personalisht me lojtarët, si me Amir Rrahmanin dhe Vedat Muriqin. Kemi pasur shumë biseda të mira", ka thënë Foda, i

cili ka treguar se si e ka pranuar ofertën e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Trajneri gjerman ka shprehur optimizëm se me "dardanët" do të arrijë rezultate të mira. "Pas një kohe shumë të gjatë që kam punuar në Zurich, e nënshkrova kontratën e re. Pas një jave më ka ardhur kërkesa prej Federatës së Kosovës. Kemi zhvilluar biseda shumë të mira. E përmendën se duan të ndryshojnë shumë gjëra në ekip. Unë edhe më herët kam punuar me lojtarë të Kosovës, në Zurich dhe te Kaiserslauterni. Kosova ka lojtarë shumë interesantë, shumë të mirë. Jam shumë i magjepsur se do të arrijmë rezultate të mira", ka shtuar Foda.

Në konferencë përzgjedhësi



Foda është pyetur edhe për mosgrumbullimin e tre futbollistëve: Ermal Krasniqi, Qëndrim Zyba dhe Muhamet

Hyseni. "Të gjithë futbollistët janë në vëzhgim tonin. Edhe ata që i përmendët janë pjesë e rëndësishme e Kosovës, por për

këto dy ndeshje kemi vendosur për këta futbollistë që janë në listë. Dera është e hapur për të gjithë. Edhe atyre do t'u vijë mundësia në grumbullimet e ardhshme. Kohën e fundit kemi qenë shumë në udhëtime, i kemi ndjekur lojtarët edhe nga afër dhe për këto arsye kemi vendosur për këta futbollistë. Gjithsesi, tani të gjithë lojtarët kanë mundësi ta tregojnë vetën", ka deklaruar Foda. "Ne kemi udhëtuar shumë. Në Bukuresht ishte ndihmësi im. Kemi pasur një grup prej 40-50 lojtarësh, por ne jemi përcaktuar për lojtarët që na kanë magjepsur më shumë. Gjithsesi secili prej këtyre lojtarëve duhet të tregojë më të mirën. Dyert janë të hapura për çdo lojtar. Secili do ta ketë rastin ta tregojë veten dhe të marrë pjesë në ndeshje, por duam që lojtarët që kemi përzgjedhur ta kenë rastin të tregojnë veten", ka përfunduar Foda. Kosova do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore në këtë muaj, fillimisht me Armeninë më 22 mars, më pas me Hungarinë më 26 mars.

Duele interesante në Ligën Unike



TIRANË, 18 MARS - Sot (e martë) zhvillohet xhiroja e nëntë në Liga Unike Femrat, apo e parafundit për garat e rregullta. Bashkimi, që ka tetë fitore në tetë ndeshje, do të përballlet me Tiranën që ka katër fitore dhe katër humbje, duke u renditur në vendin e tretë dhe do të jetë një sfidë interesante para "play-off"-it. Prishtina, që renditet e

dyta, do të ndeshet me Flamurtarin e Vlorës, ku skuadra vlonjate ka grumbulluar dy fitore dhe gjashtë humbje, duke u renditur në vendin e pestë. Sfidë interesante zhvillohet në Pejë, mes Penzës dhe Partizanit. Skuadra pejane është në vendin e katërt me tri fitore dhe pesë humbje, ndërsa ajo tiranase në

vendin e fundit me një fitore dhe shtatë humbje dhe do ta ketë të vështirë ta mbrojë titullin e kampionit.

Liga Unike Femrat - Java 9

Të martën takohen:
17:00 Flamurtari-Prishtina
17:00 Penza-Partizani
17:00 Tirana-Bashkimi

Lejson Zeqiri, MVP i javës në elitën e basketbollit

PRIZREN, 18 MARS - Bashkimi fitoi derbin prizrenas ndaj Proton Cable Prizrenit. Basketbollisti më i mirë te portokallezinjtë ishte Lejson Zeqiri, i cili e mbylli ndeshjen me 26 pikë, tetë kërcime dhe katër asistime, duke e pasur indeksin 29. Ai u shpall edhe

MVP i kësaj jave. Kujtojmë se Lejsoni ishte shpallur edhe MVP i Superkupës sa ishte pjesë e Sigal Prishtinës. Sigal Prishtina shënoi fitore bindëse dhe të pritur ndaj Istogut, derisa te bardhakaltrit u dalluan Donovan Smith dhe Visar Ejupi. Qendra Smith e

mbylli ndeshjen me 31 pikë, 17 kërcime dhe katër asistime, kurse Ejupi shënoi 40 pikë dhe shtoi edhe katër kërcime dhe tri asistime. 40 pikët ishin rekord për Visarin në elitë. Trepça po vazhdon me formë të mirë në elitë, duke shënuar fitoren e radhës ndaj

Vëllaznimit, ku Darnell Edge e mbylli ndeshjen me 20 pikë, tetë kërcime, gjashtë asistime. Fitore shumë të rëndësishme shënoi edhe Golden Eagle Ylli ndaj Pejës, ku te therandasit më i miri ishte Jalen Nesbitt me 16 pikë, gjashtë kërcime dhe dy asistime.



Totti: Nuk prisja që De Rossi të bënte kaq mirë si trajner

ROMË, 18 MARS - Ish-kapiteni i AS Roma, Francesco Totti, i ftuar në një event të “Betsson Sport”, foli për tema të ndryshme që lidhen me aktualitetin e Romës. Ky është mendimi i tij për ish-bashkëlojtarin Daniele De Rossi, autor i një fillimi superlativ si trajner i kryeqytetasve, pas shkarkimit të Mourinhos. “Nuk e

prisja që ai të bënte kaq mirë menjëherë, por shpresoja. Daniele po provon të jetë një trajner i madh dhe unë, si të gjithë tifozët verdhekuq, shpresoj që ai të vazhdojë në këto nivele. Roma është një klub i vështirë, por Daniele po demonstroi vlera si trajner i saj. Duke e njohur qytetin, tifozët

dhe klubin më së miri, ai ka bashkuar grupin dhe ka siguruar që lojtarët të performojnë me qetësi maksimale”, ka thënë Mourinho. Për Pellegrinin dhe rolin e tij si kapiten: “Pas De Rossit ishte e vështirë të gjeja një kapiten tjetër. Unë e kisha thënë tashmë se Lorenzo është një kapiten i vërtetë për Romën.

Tani është edhe fizikisht mirë, mund të bëjë gjithçka”. Për çerekfinalin e Ligës së Evropës kundër Milanit: “Kuqezinjtë po bëjnë mirë, kanë gjetur 3-4 lojtarë cilësorë dhe sasiore. Do të jenë dy sfida të mrekullueshme. Shpresoj që Roma të kalojë. ADN-ja evropiane e Milanit? Do të jetë



një faktor shtesë për kuqezinjtë, por nuk është më Milani si dikur...”

Manaj: Emocion të rikthehesh në Kombëtare, jemi të motivuar për ‘Euro 2024’

TIRANË, 18 MARS - Kjo është ftesa e parë nga trajneri Sylvinho për sulmuesin Rey Manaj. Bomberi kuqez është pjesë e grumbullimit për ndeshjet miqësore me Kilin (22 mars) dhe Suedinë (25 mars). Në prag të këtyre sfidave, Manaj ka dalë në konferencën e zakonshme për mediet. “Ekipin e gjej shumë mirë. Është emocion të kthehesh pas 1 viti e gjysmë. Të gjithë janë të motivuar se Evropiani është një gjë e madhe dhe të gjithë e presin. Kemi pasur takime me trajnerin, por të gjithë lojtarët duhet të tregojnë veten në miqësore dhe më pas vendimin e merr trajneri se kë merr në ‘Euro 2024’. Viti i kaluar ka qenë i vështirë, se e pata këtë dëmtimin, pata të njëjtin lëndim. Për në Evropian vendos trajneri, brenda mendjes time mendoj që jam gati për të shkuar atje. Kam pasur gjithmonë komunikime. Trajneri më ka takuar në Londër.



Jam i kënaqur pasi është dhe grumbullimi i parë. Tani besoj se kemi oportunitetin që të tregojmë veten në këto miqësore. Çelsin nuk e di, por kur një lojtar ka një dëmtim të rëndë, duhet të stërvitesh, të marrësh formën ishte kryesore. Në Sivas më bëri shumë mirë. Ndikoi dhe konfidenca. Duhet të jesh i fortë mentalisht”, ka thënë Manaj. “Unë besoj që ftesa

do të vinte po të bëja mirë, dhe tani që kemi Evropianin e dytë për Shqipërinë, është një oportunitet për të gjithë. E pres mirë dhe stadiumi do të mbushet. Kërkesat janë të larta. Tifozët na kanë mbështetur gjithmonë dhe ekipi pa tifozë s’është asgjë. E rëndësishme dhe kryesorja është të jetë plot stadiumi që të japim 100 %”, ka përfunduar Manaj.

Bostoni konfirmohet lider në NBA, fitojnë edhe Milwaukee dhe Miami

MILWAUKEE, 18 MARS - Bostoni konfirmon leadershipin në NBA, duke fituar me rezultat 130-104 ndaj Washingtonit dhe mbetet skuadra e vetme mbi 50 fitore këtë sezon. Celticsi bëri një tjetër ndeshje të mirë, ku u dalluan Tatum dhe Hauser, me nga 30 pikë secili. Dallasi mundi me rezultat 107-105 Denverin në fushën e tij, ku protagonist ishte Luka Doniqi, që realizoi 37 pikë e 10 rebounde. Mirë u paraqit edhe Irvingu me 24 pikë, ndërsa për kampionët u dallua Myrray me 23 pikë, por zhgënjeu Jokiqi. Pa problem fitoi Milwaukee, që mundi me rezultat 140-129



Phoenixin, në të cilën ndeshje Lillard dhe Portis realizuan nga 31 pikë secili për Bucksin. Pas kohës shtesë fitoi ekipi i San Antonios, që mundi me rezultat 122-115 Brooklyn, me Wenbanyama protagonist, autor i 33 pikëve e 15 reboundeve.

REZULTATET	
Milwaukee - Phoenix	140-129
Detroit - Miami	101-104
Dallas - Denver	107-105
Washington - Boston	104-130
Orlando - Toronto	111-96
San Antonio - Brooklyn	122-115
Clippers - Atlanta	93-110

Fitore të vështirë jashtë fushës korri Miami, që falë 30 pikëve të Robinsonit, mundi me rezultat 104-101 Detroitin. Zhgënjeu skuadra e clippersave, që u mund me rezultat 110-93 në fushën e vet nga Atlanta. Për miqtë u dallua Murray me 21 pikë.

200 fitore te Reali dhe 900 ndeshje në karrierë, Ancelotti kërkon ta thyjë tabunë e vet me madrilenët

Fitorja në Pamplona ndaj Osasunas i hap rrugën Real Madridit drejt titullit, rrethanë e favorizuar nga rënia e dukshme e performancës së Gironas në ndeshjet e fundit. Tani janë tetë pikë që i ndajnë madrilenët nga Barcelona, me vetëm 9 ndeshje të mbetura deri në përfundim të

kampionatit. Ancelotti bëri histori edhe në “Pamplona”, duke rrumbullakosur 200 fitore si trajner i Real Madridit, diçka që para tij e kishte arritur vetëm Mígel Munjoz. “Jam shumë krenar që kam arritur kaq fitore, por nuk mjaftojnë. Tani po mendoj për fitoren e 201-të”, ka thënë Ancelotti pas fitores 4-2

ndaj Osasunas, e cila ishte edhe ndeshja e tij numër 900 në elitën e vendeve ku ka drejtuar. Italiani është i vetmi trajner në Evropë që ka fituar pesë ligat kryesore evropiane. Nëse e fiton sërish titullin në “Santiago Bernabeu”, do të ishte hera e parë që do ta përsëriste këtë sukses në të njëjtin vend.

SHKURT

Alcaraz dhe Swiatek triumfojnë në Indian Wells

Ka përfunduar në Amerikë turneu Masters i Indian Wells, ku morën pjesë tenistët më të mirë në botë në të dyja kategoritë. Iga Swiatek për femra dhe Carlos Alcaraz për meshkuj triumfuan për herë të dytë në karrierën e tyre në këtë event.

Alcaraz, numri 2 në botë, mundi 2-0 (7-6, 6-1) në finale rusin Daniil Medvedev. Seti i parë ishte i ekuilibruar, ku Alcaraz fitoi në “tie break”, por më tej në fushë dominoi spanjoli, që mbrojti titullin e fituar vjet. Për Alcaraz ky është trofeu i parë për këtë vit. Numri 1 në botë për femra Iga Swiatek rikthehet te fitorja në Indian Wells pas dy vjetësh. Çuditërisht, ashtu si dy vjet më parë, ajo mundi 2-0 në finale (6-4, 6-0) greken Maria Sakkari, në një ndeshje pa shumë histori. Swiatek nuk humbi asnjë set në këtë turne dhe korri titullin numër 19 në karrierë.

Xavi: Që kur dhashë njoftimin për t’u larguar, skuadra po luan më mirë

Duke folur për triumfin ndaj Atletico Madridit me shifrat 0-3, trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka deklaruar se ekipi është duke luajtur shumë më mirë.

Spanjoli bëri një shaka, duke deklaruar se që kur njoftoi se do të largohej nga klubi në fund të sezonit, ekipi po luan më mirë. “Mendoj se kjo ishte ndeshja e përkryer për ta treguar qasjen tonë, filozofinë tonë të lojës. Jemi shumë të lumtur. Gjithçka shkoi sipas planit. Që kur dhashë njoftimin për t’u larguar, skuadra po luan më mirë. Ne po presim më shumë, po sulmojmë më shumë, po mbrohemi më shumë. Kjo është një fitore spektakolare. Tri pikë të arta. Kjo është Barça që duam të shohim dhe si trajner, jam shumë i lumtur me këtë skuadër”, është shprehur Xavi.

Enrique: Duam ta festojmë titullin sa më shpejt të jetë e mundur

Një fitore e rëndësishme e PSG-së në transfertë ndaj Montpellierit me shifrat 2-6. Në përfundim të ndeshjes, trajneri i skuadrës parisienne, Luis Enrique, foli për kanalet zyrtare të klubit. “Nuk ka dyshim, ishte një mbërme fantastike. Mendoj se e nisëm ndeshjen shumë mirë, shumë seriozisht dhe kaluam në avantazh shumë shpejt. Ne ishim pak të kujdesshëm në mbrojtje, i lamë shumë kalime kundërshtarit dhe ata u rikthyen në lojë. Në pjesën e dytë bëmë atë që bëmë në pjesën e parë, filluam me një ritëm të mirë, rifituum epërsinë dhe mendoj se ishim superiorë. Triumfi i afërt i kampionatit? Është e mrekullueshme, perfekte. Kjo është ajo që ne po kërkonim. E dinim para ndeshjes se nëse do të fitonim do të kishim 12 pikë më shumë se vendi i dytë në tabelë. Ne duam të festojmë titullin sa më shpejt të jetë e mundur dhe të mendojmë për të qenë konkurrues në të gjitha garat që na kanë mbetur”, ka thënë Enrique.

Wolfsburgu shkarkon trajnerin Kovaq

Humbja 1-3 në shtëpi përballë Augsburgut ka rezultuar fatale për kroatin Niko Kovaq, që është shkarkuar nga bankina e Wolfsburgut. Këta të fundit nuk fitonin prej tre muajsh dhe zbritja në vendin e 14-t kishte bërë që të ndizet alarmi, ndaj drejtuesit vendosën ta ndryshojnë trajnerin. Menjëherë pas shkarkimit të Kovaqit, është emëruar në stol austriaku Ralf Hasenhuttl, ish-trajner i Southamptonit në Angli për plot katër sezone. Hasenhuttl ka firmosur kontratë afatgjatë me Wolfsburgun, teksa misioni i tij do të jetë ta mbajë skuadrën në elitë. Ky është një rikthim pas gjashtë vjetësh në Bundesligë për austriakun, që në 2018-n pati drejtuar Leipzigun, teksa vlen të theksohet se gjatë kohës kur ishte te Southamptoni ka punuar edhe me sulmuesin e kombëtares shqiptare Armando Broja.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 39 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 282 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:

Përkthyes – nga gjuha shqipe në gjuhë serbe anasjelltas;

Numri i referencës:

PSA/ZKA/03-04/24

Grada:

ZKA-C6

Numri i pozitave:

Një (1)

Kohëzgjatja e emërimit:

Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit në përcaktimin e objektivave dhe hartimin e planeve të punës;
- Bën përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë.
- Bënë përkthimin simultan në takime pune, punëtori, konferenca, trajnime dhe në raste të tjera sipas nevojave të ZKA-së;
- Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim të qartë dhe sipas normave gramatikore dhe të sintaksës;
- Mban bazën e të dhënave dhe informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të të gjitha dokumenteve.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale prej tyre një (1) vit dëshmi në fushën e përkthimit.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve;
- Njohuri në terminologjinë e fushës së auditimit, kontabilitetit dhe financave;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 03.04.2024 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, kao i člana 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjen i dopunjen Pravilnikom (NKR) br. 01/2023); vezano sa članom 39 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2024. godinu, kao i Odluke Generalne Revizorke Br. 282 za popunjavanje slobodnog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS

za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Položaj:

Prevodilac - sa albanskog na srpski i obrnuto;

Broj reference:

PSA/ZKA/03-04/24

Nivo:

ZKA-C6

Broj radnih mesta:

Jedno (1)

Trajanje imenovanja:

Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže vodi odeljenja u postavljanju ciljeva i izradi planova rada;
- Vrši prevod dokumenata sa albanskog na srpski i obrnuto prema normi utvrdenoj za radni dan. Prosečna norma za prevođenje dokumenata u toku radnog dana obuhvata u proseku 2000 reči.
- Vrši simultano prevođenje na radnim sastancima, radionicama, konferencijama, obukama i u drugim slučajevima prema potrebama NKR-a;
- Pomaže u definisanju i usaglašavanju terminologije, za prevedene dokumente i dokumente, kao i njihovu tačnost sa jasnim značenjem i u skladu sa normama gramatike i sintakse;
- Održava bazu podataka i informacije u vezi sa prevodom svih dokumenata.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva od kojih jedna (1) godina dokaz u oblasti prevođenja.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti prevoda;
- Poznavanje terminologije revizije, računovodstva i finansija;
- Veština u komunikaciji i planiranja rada;
- Sposobnost izvršavanja zadataka i poslova pod pritiskom;
- Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovana;
- dokazi o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom (ne starija od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na sajtu Nacionalne Kancelarije Revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je 03.04.2024 do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. “Ahmet Krasniqi” br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručanju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër:386 /1
Datë: 18.03.2024

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars),në bazë të Ligjit Nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës te dt. 22.02.2024 me nr. 377 të **QK “11 Marsi” – Prizren** shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të QK “11 Marsi” – Prizren, në Republikën e Shqipërisë

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t’i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të ketë licencën e punës.
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet te ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjensioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KSHD-ja në Durrës (prej 29.04. deri 03.05.2024).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskusionit.
- Agjencioni turistik duhet t’i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t’i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2021-2022-2023)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt 29.04.2024 dhe kthimi më dt 03.05.2024
- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë , Durrës, Krujë, Berat, etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
 - Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
 - Menyja
 - Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
 - Gjendja teknike e autobusëve
 - Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje te shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t’i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndertesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë) Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus dy ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

Njoftim për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë “Ariani Arms”, Sh.P.K.
Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuara “Ariani Arms” SH.P.K. me numër NUI: 812113489, me seli në Vushtrri, lëshon këtë:
NJOFTIM
“Ariani Arms” ka vendosur për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë nga: 3.000.000 €, në 3000.

Ofertë për shitjen e patundshmërisë

Haxhi (Isa) Qafleshi, me adresë banimi në Bellobrad KK Dragash, është bashkëpronar të patundshmërisë, me sa vijon:

-me pjesën prej 4608/7362 e pjesës ideale të ngastrës kadastrale nr.P-71813068-08651-11, në vendin e quajtur “Buzagillëk”, me kulturë bujqësore – arë e kl.1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 7362 m2, ZK Prizren.

Shitësi **Haxhi (Isa) Qafleshi** nga pjesa e vet ideale të patundshmërisë nr. P-71813068-08651-11 oferton për shitje sipërfaqen e pergjithshme prej 725 m2 të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 9.670 € (me shkronja: Nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjet euro).

Prizren, 18.03.2024

Ofertuesi,
Haxhi (Isa) Qafleshi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dr. Ejup Zeka, Specialist Gjinekolog & Obsteter nga Rahoveci, shpall të humbur licencën e punës me numër: KO-02248-01-08, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, më datë; 24.12.2017 me validitet deri më; 24.12.2022.

- Laurant Brahimi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “Lekë Dugagjini” Prizren.

- Besijan Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Brigada 125” Medvec.

- Gëzim Halilaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari”.

- Brikena Basha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hysni Zajmi”.

- Dardan Bajrami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Valmir Rragamaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl10.11.12. të sh.m. teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Alban Selimi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gjin Gazulli” Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales





TRADITË QË NGA 1992

